



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2158/ Prot

Tiranë, më 10/08 /2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr.107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.174 prot, datë 01.09.2020 “Njoftim për shpalljen e vendit të lirë, përgjegjës i degës mësimorë pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Shkodër”, të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Shkodër Shkodër, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2159 prot, datë 04.09.2020, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 11.09.2020, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- Përgjegjës i degës mësimorë pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Shkodër

Kandidati aplikues për pozicionin e punës Përgjegjës i degës mësimorë pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Shkodër, duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master shkencor” (ose të barasvlershme) për një nga profesionet që lidhet me drejtimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;
- c) të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues të AFP-së;
- d) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.
- e) të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën profesionale të njërës prej kualifikimeve profesionale të ofruesit të AFP-së.

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letër motivimi për pozicionin;
- b) CV (jetëshkrimi), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 1 të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”;
- c) fotokopje e kartës së identitetit, e diplomës dhe e librezës së punës;
- d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- e) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- f) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- h) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit të dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Shkodër brenda datës 22.09.2020.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

